



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Komuna e Klokot-Verbovac/Opština Klokot-Vrbovac

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KLLOKOTIT
ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE

Datë: 10.07.2026

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e një (1) pozite të lirë të punës – Shtëpiak

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe në përputhje me **Rregulloren (QRK) Nr. 27/2024 për Procedurat e Konkurrimit për Nëpunësit Teknik dhe Mbështetës**, Komuna e Klokotit – Zyra e Burimeve Njerëzore shpall:

I. Të dhënat për pozitën

- **Institucioni:** Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF), Mogillë Klokot
- **Titulli i pozitës:** Shtëpiak
- **Kategoria:** Nëpunës Teknik dhe Mbështetës
- **Numri i pozitave:** 1 (një)
- **Lloji i kontratës:** Me kohë të pacaktuar
- **Periodha provuese:** 6 (gjashtë) muaj
- **Orari i punës:** I plotë (40 orë në javë)
- **Koeficienti i pagës:** 4.80

II. Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësie

Shtëpiaku është përgjegjës për:

1. Kujdeset për mirëmbajtjen e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe hapësirave përcjellëse.

2. Kryen riparime të vogla teknike dhe eliminon dëmtimet e lehta në dyer, dritare, mure, dysHEME, inventar dhe pajisje të tjera.
3. Kujdeset për funksionimin e instalimeve elektrike, ujësjellësit, kanalizimit, ngrohjes dhe sistemeve të ndriçimit, si dhe njofton përgjegjësit për defektet që kërkojnë ndërhyrje profesionale.
4. Mirëmban oborrin, trotuaret dhe hapësirat e jashtme të QMF-së.
5. Kujdeset për pastërtinë dhe rregullsinë e ambienteve të përbashkëta sipas nevojës.
6. Transporton dhe sistemon materialet, inventarin dhe pajisjet brenda institucionit.
7. Kujdeset për përdorimin dhe ruajtjen e mjeteve të punës dhe inventarit.
8. Ndhmon në organizimin e aktiviteteve të institucionit sipas kërkesës së udhëheqësit të QMF-së.
9. Respekton rregullat për sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen nga zjarri dhe standardet higjieno-sanitare.
10. Bashkëpunon me personelin shëndetësor dhe administrativ për mbarëvajtjen e punës.
11. Kryen edhe detyra të tjera që lidhen me pozitën e punës, sipas kërkesës së udhëheqësit të QMF-së ose drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë.

III. Kushtet e përgjithshme

Kandidati duhet:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të ketë gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrave.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale që e bën të papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës.

IV. Kushtet e veçanta

- Të ketë të paktën arsim fillor të përfunduar; arsimi i mesëm përbën përparësi.
- Të ketë aftësi praktike për mirëmbajtjen e objekteve dhe kryerjen e riparimeve të vogla.
- Të ketë aftësi fizike për kryerjen e detyrave të punës.
- Të jetë i përgjegjshëm, korrekt dhe i disiplinuar.
- Të ketë aftësi për punë në ekip dhe komunikim.
- Përvoja e punës në mirëmbajtjen e objekteve ose në pozita të ngjashme konsiderohet përparësi.

V. Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

1. Formularin zyrtar të aplikimit të plotësuar.
2. Kopjen e letërnjoftimit.
3. Kopjen e diplomës ose dëshmisë së shkollimit.
4. Dëshmi për përvojën e punës (nëse posedon).

5. Dokumente të tjera që dëshmojnë kualifikimet e kërkuara.

Kandidati i përzgjedhur, para lidhjes së kontratës së punës, obligohet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit në fuqi.

VI. Afati i aplikimit

Afati për aplikim është **15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike**, duke filluar nga dita e publikimit të konkursit.

VII. Mënyra e aplikimit

Aplikacionet dorëzohen fizikisht në Zyrën e Burimeve Njerëzore të Komunës së Kllokotit.

Aplikacionet e pakompletuara ose të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

VIII. Procedura e përzgjedhjes

Përzgjedhja e kandidatëve zhvillohet në përputhje me Rregulloren (QRK) Nr. 27/2024 dhe përfshin:

- verifikimin administrativ të aplikacioneve;
- intervistën me kandidatët që plotësojnë kushtet e konkursit;
- përzgjedhjen e kandidatit me rezultatin më të mirë.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet e konkursit do të ftohen në intervistë.

IX. Informata shtesë

Për informata shtesë kandidatët mund të drejtohen në Zyrën e Burimeve Njerëzore të Komunës së Kllokotit gjatë orarit zyrtar të punës.

ZYRA E BURIMEVE NJERËZORE

Nehat Rexhepi

